



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 484/g Prot.

Pogradec, më 26.11.2025

VENDIM

NR. 115, DATË 25.11.2025

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 10.11.2025 TË  
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli i Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 10.11.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec, të datës 10.11.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 21 vota

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 25.11.2025



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 10.11.2025

ORA : 13:00

PREZENT: 24 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC  
DATE 10.11.2025 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës. 31.10.2025
4. Projekt- Vendimi : Për miratimin e planit të Mbarshtimit të Pyjeve dhe Kullotave Për Ekonomitë Pyjore Qafë – Panjë dhe Guri I Nikës.
5. **Projekt – Vendim :** Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore telefon, energji, tv kabllor, internet”
6. **Projekt – Vendim :**Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 34.6600 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.
7. **Projekt – Vendim :** “ Për Akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Taulant Hamolli për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor.”
8. **Projekt – Vendim :** “ Për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Fatos Hamza, për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor, jashtë vëndit të djalit të tij të mitur, Alteo Hamza”.

**Z.Kryetare: Përshëndetje të nderuar këshilltarë.** Mbledhjen jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak e deklaroj të hapur. Kjo mbledhje po zhvillohet me kërkesë të 1/3 –tës të Këshilltarëve. Janë dërguar materialet e mbledhjes në të gjithë Këshilltarët si në mënyrë elektronike edhe në hard copy.

Bëhët prezenca e Këshilltarëve.

Prezent janë 25 këshilltarë.

Znj.Kryetare: Vazhdojmë me rendin e ditës. Lexohet rendi I ditës.

Po Znj.Biba pastaj Z.Male.

Znj.Biba: E nderuar znj.Kryetare, të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës, ne sot jemi mbledhur këtu për mbledhjen jashtë rradhe me një rend dite të përcaktuar dhe jemi të gjithë deshmitarë për atë që ne diskutuam në mbledhjen e kaluar. Ne vendosëm për dy pika që do të kalonim në një mbledhje jashtë rradhe, një ka dhe një projekt-vendim tjetër e cila na serviret në shpallje kjo është e jashtëligjshme. Nëse ka ndonjë mënyrë tjetër për ta sjellë këtë projekt-vendim ka atë gjejeni ju, dhe që thuhet me 1/3 nuk ka ligj ta justifikojë. Kështu që unë nuk jam dakort kjo duhet të votohet njëhërë pastaj duhet diskutuar. Ky është një projekt-vendim që nuk ka kaluar as një javë që u hodh poshtë po nga ky keshill dhe u soll sërish.

Znj. Kryetare :Unë thjesht po të sqaroja nga ana ime, ne shtymë ato dy pika .Ka ardhur një kërkesë me 1/3 e Këshilltarëve.

Znj.Topa: E kam thënë edhe herë të tjera, nuk mund të thoni nuk është ligji.

Znj.Biba : Unë thashë që nuk ka ligj që ta miratojë.

Znj.Topa: Në mbledhjen e rradhës që ishte ne datën 31 Tetor, diskutim për dy pika që do të shtynim për tu trajtuar në një mbledhje jashtë rradhe. Nuk duhej cilësuar data, këtu ka një keqkuptim sepse u ngritën kartonat sikur u vendos dita dhe ora, data u tha dhe ora u tha ,por zyrtare është kërkesa që ka në zyrë sekretarja e Këshillit. Mbledhja jashtë rradhe u thir nga kërkesa e 1/3 të Këshilltarëve të cilët në kërkesë futën dhe projekt-vendimin e Cëravës duke qënë se erdhi me



ndryshime. Mbledhja jashtë radhe thirret nga Kryetari, 1/3 e Këshilltarëve ose nga Prefekti. Qëndron që Cdo kush ka të drejtën e kartonit edhe mund ta përdori atë nuk mund të diskutohet pse e s'ole kur jemi mbrënda edo rregulli. Gjithashtu neni 62 i Rregullores së Këshillit Bashkiak I cilëson qartë pikat e një mbledhje jashtë radhe. Kur të vijë moment për votim secili ka të drejtë të votojë I lirë.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me mbledhjen ju lutem , flasim me radhë.

Z. Male: Po është shumë e vërtetë qe mbledhja jashtë radhe thirret nga ato tre pika që tha znj. Topa, ne duhet të pranojmë që kemi bërë një gabim në mbledhjen e kaluar ne kemi caktuar edhe axhendën për dy pika.

Znj. Kryetare: Ne sapo e sqaruan këtë.

Z. Male: Ju këtu keni ardhur për të bërë zhermë, ju respektova më dëgjoni deri në fund le të bëj edhe gabim. Ne bëmë një gabim që u thirrëm vetëm për këto dy pika edhe për pikën 7 u vendos në rendin e ditës me 2/3.

Znj. Kryetare: Nuk I vendosëm I shtynë.

Z. Male: Gjithsesi nuk është temë debati kjo se edhe po të mos e kishit vendosur sot do e kishit vendosur në fund të muajit.

Znj. Kryetare: Po mos ta vendosnim do thonit pse se vendosët.

Znj. Topa: Mos I ngatëroni thuhet me 2/3 e pjesmarjes, thirja nuk votohet por bëhet me 3 procedura.

Z. Male : Duhet të pranojmë që kemi bërë një gabim kaq.

Znj. Topa: Ngrini kartonin edhe votoni.

Z. Male: Unë e kuptoj që ju sot jeni shumë të motivuar, se keni edhe Kryetarin pjesëmarrës. Sot do kalojë, por ju po tregoni që jeni shumë të dobët nga kryetari I pari edhe deri tek ju.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me rendin e ditës përveç pikave 6 që janë, kanë ardhur edhe dy projekt-vendime shtesë, këto do hidhen në votim një për një, po I lexoj.

“ Për Akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Taulant Hamolli për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor.”



Hidhet në votim

Znj.Kamolli: Miratohet për të hyrë në rendin e ditës me 24 vota pro.

Znj.Kamolli: Vazhdojmë me projekt-vendimin e radhës.

" Për akordinin e ndihmës financiare për familjen e Z. Fatos Hamza, për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor, jashkë vëndit të djalit të tij të mitur, Alteo Hamza".

Hidhet në votim.

Miratohet për të hyrë në rendin e ditës me 24 vota pro.

1. " Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53. pika 4 dhe Regullores se Keshillit Bashkiak nr 40, ligji 139/2015".

Hidhet ne votim Rendi 1 dites.

#### **U votua**

**Pro** 21

**Kundër** 2 (Arbër Male) (Klajdi Gjona)

**Abstenuim** 1 (Marjeta Riba)

**Miratohet** Pa Jo



**Z.Male:** Për konfliktin e interesit .

Znj.Kamolli: Tani po e them më ler ta mbaroj.

2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Diskutime

Znj.M.Kamolli: Deklarimi I konfliktit të interest është një proces rutinë që bëhet në fillimin e cdo mbledhje. Nqs dikush ka konflikt interesi duhet ta deklaroje .

Z.Male: Në Qoftë se këtu në Këshill ka njerëz të punësuar këtu në Bashki ose në ndërmarrje në varësi duhet të deklarojnë, Unë personalisht do bëj kërkesë për këtë pikë.

Znj.Kryetare: Unë e kam lexuar në cdo mbledhje dhe cdo kush nga Këshilltarët është I përgjegjshëm të deklarojë konfliktin e interest.

Z.Shyti: Ai që ka konflikt interesi është I përgjegjshëm dhe mban vetë përgjegjësi. Ti cfarë problem ke.?Meret ligji me këtë.

Znj.Kryetare : Vazhdojmë.





Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 10.11.2025

“ Miratimi i Procesverbalit te datës 31.10.2025

Diskutime

Znj M.Kamolli : Procesverbali I mbledhjes së datës 31.10.2025 është dërguar , nqs dikush nuk ka dicka për të diskutuar e hedhim në votim

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 10.11.2025

**4.Pika** Projekt- Vendimi : Për miratimin e planit të Mbarshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave Për Ekonomitë Pyjore Qafë – Panjë dhe Guri I Nikës.

Diskutime

Znj.Kryetare: Ky është një projekt-vendim I diskutuar edhe sot ka ardhur z.Lufo për të na dhënë më shumë informacion në lidhje me project-vendimin.

Z.Lufo: Përshëndetje të gjithëve, Plani I Mbarështrimit është një dokument strategjik afatgjatë I cili përcakton inventarizimin e grumbujve Pyjor në njësi ekonomike . Nga inventarizimi nxjerr gjëndjen faktike reale për propozimet që bëhen atje në harkun kohor 10 vjecar, masat që duhet të meren. Pas miratimit ligji e përcakton qartë që duhet të kalojë në miratim praparak të Këshillit Bashkiak, pastaj shoqërohet me një miratim nga Ministria.

Znj.Kryetare: Besoj jemi të qartë edhe për arsyen se pse ne e shtymë.

Znj.Topa: Ky projekt-vendim ndryshon komplet nuk ka lidhje me atë të parin.

Z.Pikuli: Ne marim një projekt-vendim për mbarshtrim cfar keni bërë ju për këtë. Nuk ka lidhje me inventarizimin. Pyetja ime ekziston në 1 ha sa m3 sa do shtohet?

Z.Lufo : Është koncepti mbarështrim edhe njëherë ka edhe një nocion tjetër që quhet qeverisje janë të dyja si thuhet sinonimi I njëra tjetrës .

Z.Pikuli: Edhe njëherë ti the që ky plan që sollët ju do bënit inventarizim.

Z.Lufo: Pasi inventarizojmë është pjesa e menaxhimit.

Z.Pikuli: Cfarë do bëni ju dicka konkrete.

Z.Lufo: Pas miratimit final....

Z.Pikuli: Jo pra në plan cfar do bëni sa mendon të shtosh ti.

Z.Lufo: Edhe njëherë ne nuk shtojmë gjë, ne vetëm mund të ndërhyjmë me masa për të përshpejtuar rritjen , nuk mund të shtojmë gjë se nuk mund të bëjmë mrekullira. Shtimi bëhet njëherë në 5 vjet pas miratimit të kadastrës.

Z.Pikuli: Edhe një here e miratuam , cfar do shtoni ju?

Z.Lufo: Ne zbatojmë masat se cfar rrjedhin nga ai dokument.

Z.Pikuli: Dokumenti është një punë fomrale, punë praktike punë konkrete, sa keni shtuar.

Z.Lufo: Nuk kemi shtuar gjë pot ë them edhe njëherë.

Z.Pikuli: Atëhere për cfarë e keni sjell këtë plan.

Z.Lufo: Propozojmë masat.

Z.Pikuli: Të gjitha masat janë në funksion mos pritet një pemë më shumë ,të shtohet një pemë më shumë. Ju cfarë keni shtuar?

Z.Lufo:Atje propozohen po ju them edhe njëherë.

Znj.Kryetare: E do dikush tjetër fjalën.

Z.Kryetar: Këshilltari po thotë cfar përfitimi ka.

Z.Lufo: Atëhere përfitimin e marim në kontekstin tjetër, mbledhja e materialeve drysore që bëhet në masën e përfituar shkon për shkollat, për entet,cerdhe.

Z.Pikuli: Jo jo këto që duhen duhen edhe një herë për atë që pyeta.

Z.Lufo : Unë mbarshtimin e konceptoj ndryshe:

Znj Silvana: E po sqaroje se këtu ngul këmbë Fredi , përvec këtyre që priten a do këtë shtesa.

Z.Kryetar: Thuaji a do këtë shtesa.

Z.Lufo:E thash nga propozimet që dalin planifikohen të gjitha , është plani 10 vjecar.

Z.Qeva: Mbarshtimi I pyejeve që thotë z.Pikuli , do të thotë të rish 3 muaj me cadrra të rish të bësh projektin, sot nuk kemi inxhiniera të mirfilltë ata që kishim na lanë kështu do kënaqemi me këta të rinjtë.Sa për pyjet kanë nevojë pa fund se vetëm masakrohen edhe janë nja tre që dalin rrugëve vetëm pasurohen. Ja ti bëj një pyetje z.Lufo . Sa ka në zonën e Bishnicës?

Z.Lufo: Si me ventarizim me dy ekonomi që ne kemi në miratim llogaritet diku tek 245 mij m<sup>3</sup>.

Z.Qeva: Po në teren?

Z.Lufo: Në teren dihet që ka ndryshime patjetër.

Z.Qeva: Cfar mase?

Z.Lufo: Masat administrative ashtu sic është operuar gjithmonë.

Z.Qeva: Po a ke shkelur ndonjëherë?

Z.Lufo: Po sigurisht që kam shkelur.

Z.Qeva: As një njeri nuk ka shkelur as një inxhinier edhe as një teknik. Është mëkat të shkatërrosh pyjet pa fund sepse do e vuajnë breza me rradhë, një pyll do sa një brez njeriu të dali prap.

Z.Male: Kam vetëm një pyetje të vogël. Unë jo vetëm si një këshilltar por edhe si një qytetar nuk na intereson vetëm mosprerja por kujdesi i tyre, sepse ne nqs e kapim të prerë dëmi është bërë. Ka shumë ankesa nga banorët e zonës së Mokrës se si do ja arrini ju këtë e dini që të shtoni masat jo vetëm administrative por dhe kontrollat në terren. Duhet bërë dicka urgjente sepse është një problem shumë i madh.

Znj.Kryetare: atehere e hedhim për votim.

U votua

Pro 20

Kundër 2 ( Klajdi Gjona) (Marjeta Biba)

Abstenim 2 (Fredë Pikuli) (Arbër Male)

Miratohet Po JO





## Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 10.11.2025

- Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore telefon, energji, tv kabllor, internet.

### Diskutime :

Z.Tani : Kam për të bërë një sqarim këtu.

Znj.Kryetare: Ju lutem mund të flasin njëherë përfaqesuesit nga Bashkia. Të sqarojmë njëherë projekt-vendimin, të flasin dhe këshilltarët dhe pastaj ja u jap fjalën.

Z.Paskalino: Cdo investim i ri që po bëhet krahas infrastrukturës po shtrihen edhe tubat për linjat e telekomunikacionit nga ana e Bashkisë. Me synimin që të minimizojmë deri sa të largojmë përfundimisht rrjetin e mirimangave që sot kemi nëpër lagje. Për këtë arsyeje kërkojmë sot nga Këshilli Bashkiak që ti hapi rrugët Bashkisë që të ketë të drejtë të lidhë kontratë patjetër kundrejt tarifave të pakerës fiskale të miratuar nga ne, për këta operatorë që do kërkojnë shtrirjen e rrjeteve nga ne për të mos përdorur linja ajrore por linjat tokësore, pra ato që janë. Sot kemi disa jo shumë, do të bëhen investime të reja Rruga Rinia, Rruga Reshit Collaku, lagjia historike që është duke u bërë, do të bëhet shëtitëria dhe kjo ka përsëri tubacione të lira nga të dyja krahët, është Tushemishti që është dhe investim i ri dhe atje ka. Pra janë të gjitha investime të reja që do të bëhen do të kenë dhe tubacione për rrjetin e telekomunikacionit.

Prandaj duhet vendimarrja nga Këshilli Bashkiak për ti dhënë të drejtën Bashkisë kuptohet me të gjithë dokumentacionin e duhur përkatës që duhet të plotësojë cdo kompani që do të operojë në qytet. Këto kompani do të dorëzojnë dokumentat përkatëse bashkë me lincsimin e tyre kuptohet për të përdorur këto linja që ka Bashkia për të mos ngelur bosh por edhe për të ardhurat që i sjell Bashkisë pse jo, edhe dicka që është edhe më e rëndësishme rrjetin disiplinor për të mos patur atë rrjet mirimangash mbi kokat tona.

Znj. Biba: Më fal ju po thoni që keni të drejtën të jepni tubacionet ekzistuese. A ka hartë Bashkia që të di se kush janë këto tubacione ekzistuese?

Z.Paskalino: Ekzistuese edhe për ato që do të bëhen. Këto përmenda unë investimet e reja që janë bërë ka tubacione për këto rrjete.

  
Sot kemi Rruga Rinia, Rruga Reshit Collaku ,kemi dy lagje historike që janë në process kemi Tushemishtin kemi shëtitoren nga moli që themi dhe deri në Drilon që do të filloj së shpeti. Prandaj ne nuk kemi një hartë sepse është një process në vazhdim. Prandaj këto tubacione që janë pronë e saj pra pronë e Bashkisë të kemi të drejtë ti japim kundrejt një tarife operatorëve që janë të interesuar.

Znj.Biba: Ka tubacione të tjera në Pogradec që momentalisht përdoren nga këta operatorë sic është Vodafon , One etj. Nëse këto janë si tubacione pse duhet të hapen të tjera po mar si shëmbull lagjen e Proi I Caprazit.

Z.Paskalino: Nuk hapen të tjera.

Znj.Biba: Po thoni që po bëhen të tjera.

Z.Paskalino : Po themi që investimet e reja që po bëhen do kenë këto tubacione nuk do hapen të tjera ne këtë duam që mos hapen të tjera.

Znj.Biba: A po shfrytëzojmë ne këto të operatorëve të tjerë?

Z.Kryetar: Kjo po thuhet që ne nuk duam që të hapen rrugë të tjera edhe gropa por të ruajmë dhe të rregullojmë këto.

Znj.Biba: Po më fal po ne internetin e duam edhe atje në njësi.

Z.Paskalino: Ju keni shumë të drejtë edhe ate do të bëhet.

Znj. Biba : A mund ta mari fjalën personat që janë të interesuar edhe pastaj vendosim.

Znj.Gjoshe: Po njësitë

Znj. Biba : Bashkia ka në njësitë tubacione.

Z.Paskalino : Bashkia përvec Tushemishtit nuk ka.

Z.Qevo: Po është edhe trotuari që ka.

Z.Paskalino : Po keni shumë të drejtë është trotuari që ka nga të dyja anët.





Z.Qeva: Përderisa këto tubacione janë në këtë zonë kjo pjesë që është pse të mos shfrytëzohet, rrinë këto kabulla të varura prishin komplet imazhin përderisa këto tubacione janë pse mos shfrytëzohen.

Z.Kryetar: Të flasë ai që është i interesuar.

Znj.Kryetare: Të flasin njëherë Këshilltarët edhe pastaj tja japim fjalën Z.Tani.

Z.Pikuli: Që Bashkia mendon që aksionet e veta ti japë me qera kjo është një punë shumë e mirë që të shfrytëzohen të vetme pyetje që unë kasha është. Sa është inventari sot dhe sa është tarifa ?

Sa është tarifa që llogaritet me metra, kilometra atë e dini ju?

Sepse në relacion është theksuar por unë nuk kam parë as një veprimtari për kanalet nëntokësore.

Z.Paskalino : Ka qënë një tarifë fikse për operatorët kabllorë që është në fuqi akoma, nuk e di 250 mij lekë të reja në vit kam përshtypjen.

Z.Pikuli: Pse ta bëjmë kështu kur ne kemi mundësi ta zbresim atë tarifë nga taksat.

Z.Paskalino: Mqs ne kemi përpara miratimin e paketës fiskale, pra deri në miratimin e paketës së re fiskale do të funksionojë me tarifë fikse. Në miratimin e paketës fiskale do vendosim një tarifë që të ketë llogjikë duke u llogaritur sioas m2 a nuk e di si do e vendosim. Mendoj që do të jetë tarifë për linjë të shtruar që do të përdoret.

Z.Pikuli: Sa do të jetë interesi i Bashkisë?

Z.Kryetar: Interesi më shumë është që most ë na shëmtohet qyteti se sa monetarisht.

Z.Pikuli: Atëhere vjen pyetja më e drejtpërdrejtë. Sa është interesi i Bashkisë për këto që do japë.

Z.Paskalino: Ne nuk po investojmë për këtë punë ato janë.

Z.Pikuli: Dakort pra prap ato që janë sa është interesi.

Z.Pasko: Është ato që thamë se ato përcaktohen me Linear.



Z.Pikuliu: Në Relacion nuk përcaktohet as metrat as kilometrat që do të jepen as hartat.

Z.Pasko: Ska harta se hartat ndryshojnë cdo ditë.

Z.Kryetar: Kjo është në parim njëherë që të jepet me qera apo jo kjo është.

Z.Pasko: Këtë e kanë të gjitha Bashkitë nuk është se po e bëjme, ne e pamë që kjo pjesë është vakum tek ne dhe prandaj duhet bërë.

Z.Kryetar: Enjela na i shpjego pak në çfar vendimi të Këshillit Bashkiak është kjo.

Znj.Enjela: Në paketën Fiskale është tarifa e kabllorit për qytetin e kemi 250 mije të reja në vit, për Njësitë administrative Udënisht edhe Bucimas e kemi 150 mijë dhe 4 njësitë e tjera e kanë 100. Kjo është fikse pasi ne nuk kemi informacion se sa kilometër linear. Në momentin që ne nuk kemi këtë informacion.

Z.Kryetar: Me çfar vendimi ishte?

Znj.Enjela: Me paketën fiskale.

Z.Kryetar: Të çfar viti?

Znj.Enjela : Për herë e kemi pasur. Këtë vit jemi 100% të realizuar e kanë paguar të gjithë dhe kemi mbledhur 19 milion të vjetra, të gjitha subjektet e kanë paguar.Kemi fituar edhe procesin gjyqësor me one , na ka hedhur sepse ai pretendonte se ai nuk duhet ta kishte paguar këtë tari. Ndërkohë që ai shfrytëzon hapësirat edhe kabllat në të gjithë qytetin edhe ne i kemi fituar këto gjyqe.

Znj.Marjeta: Këto janë tubacionet që ne kemi ne spo dimë sa kemi.

Z.Kryetar: Tre herë i ka thënë Paskoja tani ti japim me qera apo mos ti japim?

Znj.Enjela: Të them edhe dicka që këto shtrimet në të gjithë qytetin do i japë një mundesi që të mos kemi këto problem që ne kemi tani.

Znj.Shuli: Më fal cdo subjekt i ri të shfrytëzojë linjat që ka Bashkiaa jo ato private.

Z.Kryetar: Tja japim fjalën atij që është i interesuar se i di më mirë.

Z.Tani: Të nderuar Këshilltarë unë jam përfaqësuesi i TV Kabllor, jam këtu për të shprehur shqetësimin tim për projekt-vendimin që kërkon të miratohet sot për dhënien me qera të tubacioneve. Së pari dua të sqaroj që në Pogradec ushtrojnë aktivitetin 3 kompani është vodafon, one dhe inkusat. Të treja këto kompani kanë ndërtuar rrjetet e tyre nëntokësore edhe ushtrojnë aktivitetin konform ligjeve në fuqi edhe janë të paisur me të gjitha dokumentacionet përkatëse. Për momentin Bashkia e Pogradecit nuk ka as një tubacion funksional edhe nuk ka pse të ketë sepse këto investime në të gjithë Shqipërinë i bëjnë vetë kompanitë që janë të interesuara. Falë investimeve që kemi bërë është ndër qytetet e pakta që nuk ka as një kabull në rrugët kryesore. Aktualisht në të gjitha rrugët kryesore ka 6 tubacione nëntokësore, ku dy tubacione i ka Vodafon edhe 2 i ka Inkusat dhe 2 One pra janë gjithsej 3 kompani dhe me popullsinë që ka Pogradeci do të mjaftonte vetëm një tub. Pra në Pogradec ka mjaftueshëm tubacione ku secila kompani mund të shtrijë rrjetin e vet duke lidhur kontrata me kompanitë që kanë këto tubacione edhe nuk do jetë e nevojshme të cahen përsëri rrugët sepse si e thashë këto janë të mjaftueshme për një qytet si Pogradeci. Cdo kompani është e interesuar vetë që ta japë rrjetin me qera. Unë mendoj që gjithë ky nxitim që doni të miratoni këtë Projekt – Vendim bëhet sepse një kompani nga Korca të vijë edhe të ushtrojë në mënyrë të paligjshme rrjetin. Kjo kompani pas tre viteve pa u pajisur me as një lloj leje dhe për të shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme rrjetin e OSHE edhe ku të mundet kërkon ti bëjë një dëm qytetit tone ndërkohë që ne kemi investuar 500 mijë euro vetëm për ngritjen e rrjetit nëntokësor. Kjo kompani kërkon të bëjë konkurrencë të pandershme për ti kursyer asaj investim dhe të shtrijë ku të mundet meqënëse Bashkia nuk ka një rrjet të vetin tokësor. Të nderuar Këshilltarë me respekt të barazisë ju ftoj që ta shikoni me barazi dhe me ndershmëri këtë vendim. Me shpresë pavarësisht bindjeve partiake shpresoj të merni vendimin e duhur. Faleminderit që më latë të shprehësh, nqs keni ndonjë pyetje.

Z. Paskalino : Ky Projekt-Vendim nuk ka as emër edhe as mbiemër ashtu sic e the ti që ka operator që kanë rrjetin e tyre edhe Bashkia ka aq sa ka ashtu sic janë interesuar operatorët të japin me qera ashtu është edhe Bashkia Ky projekt-vendim i hap rrugën Bashkisë për aq sa ka tregu është i hapur për secilin ata do operojnë në tubacionet që janë nën tokë. Një pjesë i ka bashkia nuk janë në funksion por janë të bashkisë. Projektet e reja që vijnë i kanë të planifikuara ne po kërkojmë të drejtën që Bashkia ti vejë në funksion për ato tubacione që ka. Nuk bëhet ky projekt-vendim as për emër konkret kompanie as për segment konkret tubacioni.

Z.Tani: Në momentin që ju si keni cfar po lëshoni me qera.



Z.Paskalino: I kemi, I kemi në disa pjesë.

Z.Tani: Ne I kemi në të gjitha pjesët.

Z.Paskalino: Shumë mirë atje ku I keni ju le të përdorin tuajt ne nuk po themi gjë, aman ato tubacione që ne kemi që përmënda unë më parë pse të rijnë kot.

Z.Kryetar: Ne nuk pengojmë as një të bëjë kërkesa ju e thatë është tregu I lirë problem është që lejën e përdorimit duhet ta kenë të gjithë.

Z.Paskalino: Patjetër nuk mund të operojë në qytet apo në fshat pa lejat përkatëse.

Znj.Kryetare : Atë e parashikon edhe ligji.

Z.Kryetar: Unë jam dakort me ty Tani edhe ne jemi munduar të paktën të flasim hapur, por ti se pengon dot se ai të hedh në gjyq. Ai thotë me jep lejë të futem të operoj edhe unë. Smund të pengojmë tjetrin edhe tit hemi që ti syn dot.

Z.Tani: Janë 150 licenca.

Z.Kryetar: Po kjo pra është konkurrencë. Me ligj nuk pengon dot unë dua të hy. Të vihen kritere jam dakort ata të vihen në mënyrë të barabartë me ty edhe me cdo operator tjetër. Mos e lejojmë të hidhet nëpër pemë ose të bëjë marveshje me ju nqs do vi , por për ta penguar ne nuk e pengojmë dot.

Znj.Kryetare: Ka edhe disa kritere që thotë ligji, e drejta për akses në strukturën publike sipas ligjit neni 4 cdo operator I lirë ka akses në infrakstrukturën e këtij të fundit.

Më pas thotë arsyet pse ne duhet ti refuzojmë , në ka arsye kush janë këto më pas vinë hapat ku mund të ankoheni . Nuk është Bashkia palë por janë institucionet.

Z.Haxhillari: Me sa kuptoj unë Tani e ka problemin ku atje ku ka tubacione të lira mos jepet lejë e re port ë shfrytëzohet ato që janë.

Znj.Kryetare: Lejën nuk e mer nga bashkia por e mer nga institucionet përkatëse.

Z.Kryetar: Tani thotë që mos hyjë më asnjëri edhe me të drejtë.

Znj.Marjeta: Të hynë në konkurrencë të drejtë që aty ku nuk ka Bashkia mos hapë më kanalizime port ë shkojë ke operatorët e tjerë. Në të kundërt të shfrytëzojë vetëm ato që ka bashkia ato qe ka, jemi dakort.

Z.Kryetar: Ju ku I keni vënë?

Znj.Marjeta: Ne I kemi mbi ato shtyllat.





Z.Kryetar : Po pra. Ne nuk po diskutojmë këtë ne po diskutojmë ti japim këto që kemi me qera apo mos I japim.

Znj.Marjeta: Atje ku ska Bashkia të shfrytëzojë këta të tjerët.

Z.Kryetar : Kë të tjerë, elektrikun. Është e paligjshme nuk lejohet ne I kemi lejuar por nuk duhet.

Z.Haxhillari: Ne këto që kemi do I japim me qera.

Znj. Kryetare: Ne e miratojmë parimisht.

E hedhim në votim atëhere.

**U votua**

**Pro** 21

**Kundër** 0

**Abstenim** 3

**Miratohet** Po **JO**



**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

**Pogradec më 10.11.2025**

-Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 34.6600 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.

N. Torra- Nga hera e fundit ne kemi ardhur në Këshill me një propozim duke marrë në konsideratë kërkesat e banorëve dhe pozicionin e pronave. Dhe në këtë rast nga projekt-vendimi I parë që kemi propozuar në këshill ka një ndryshim sepse janë hequr dy sipërfaqe toke midis kullotave dhe pjesën tjetër e kemi propozuar për vazhdimin e procedurave për dhënie me qera. Ligji dhe Udhëzimi nr 1 për dhënien me qera të tokave nuk përcakton qëllimin e destinacionit për tokat bujqësore por merr parasysh ligjin për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, dhe ndryshimet përkatëse në Udhëzime. Këshilli hedh në miratim për vazhdimin e procedurave dhe bordi I qiradhënies të tokës bujqësore në bazë të propozimeve që vijnë nga kërkues të ndryshëm do të marrë vendimin për zhvillimin e këtyre tokave.

A. Male: Ky projekt- vendim ka kaluar midis shume debatesh. U be dy muaj që diskutojmë në lidhje me këtë projekt-vendim. Është krijuar ideja sikur ne nuk duam të kontribuojmë në zhvillimin e vendit por nuk është e vërtetë sepse ka pasur projekt-vendime të tjera për dhënien e tokave me qera ku nuk ka pasur kudërshtime dhe ne kemi votuar pro. Ndërsa në rastin konkret në Njësinë Administrative Cërravë është e njohur që atje zhvillojnë aktivitetin ekonomik një pjesë e mirë e familjeve të Cërrravës të cilët vit pas viti janë prekur nga dhënia e tokave me qera personave të panjohur gjë e cila ka shfaqur një shqetësim në komunitet. Do te filloj që nga mënyra se si jepen këto toka dhe personat që ju jepen, mundësitë që ju ofrohen. Mudësi që nuk ju jepen banorëve. Banorët prej dy vitesh janë interesuar për ti marrë këto toka me qera dhe nuk ju është mundësuar nga ana e Bashkisë Pogradec. Një problematikë tjetër, Kontrolli I Lartë I Shtetit kërkon nga kryetari I Bashkisë të ngrihen grupet e punës për monitorimin e kontratave të qerasë dhe një nga ato kontrata është që Bashkia Pogradec dhe Drejoria e Taksave nuk kanë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi: Bashkia Pogradec të vendosë marrëdhënie kontraktuale me operatorët ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qerave të sipërfaqeve totale prej 293 ha duke aplikuar tarifa me cmim minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qerave referuar llogarive që ka bërë grupi I auditimit,



vlera 18 milion e 172 mij e 200 leke per 8 subjekte të cilat nuk paguajnë sot kontratë qeraje. Keni ju aftësinë dhe forcën për të shkuar dhe për tju marrë këtyre kompanive minerale kontratat e qerave, Jne 100 e 87 milion leke të munguara në buxhetin e Bashkisë.

M.Kamolli: Nuk është tema për të folur për këtë çështje ,mund ta paraqesni kur të votojmë buxhetin. Po ju ikin minutat

A.Male: Po shfrytëzoj rastin që është kryetari i Bashkisë, Jo çfarë afati më ka ngelur më thuaj ligjin që është 2 min.

M.Kamolli: Është 2 min dhe në ligj dhe në rregullore dhe nqs të japin fjalën 2/3 e Këshilltarëve mund të flasësh 10 min.

A.Male: Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka lënë detyrë Kryetarit të Bashkisë që në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë raportin përfundimtar të auditimit të realizuar në Bashkisë Pogradec. Tjetra une kam dhe një pyetje tjetër. Kush janë përfituesit e këtyre tokave në shumicën e rasteve dhe a ka drejtorë të Bashkisë Pogradec që përfitojnë direkt ose indirekt. Nga ana tjetër penalizohen banorët që punojnë me mish dhe me shpirt për ekonomite e tyre familjare.

Tjetra, pse nuk ja u jepni këto ekonomi banorëve.

M.Kamolli: Si tja u japim pa miratuar?

M.Shuli: Po prandaj bëhet kjo që ta marrin me qera banorët.

A.Male: A prandaj jepet për banorët?

I.Xhakolli: Nuk të dhimbsen ty banorët më shumë se mua. Në qoftëse mbarove mendimin të vazhdojmë të dëgjojmë të tjerët.

A.Male: Më dhimbsen më shumë se ty.

z.K.Muellari: Zoti kryetar ndjesë për shetësimin është kryetarja që flet atje jo ti. Nuk jeni ju përgjegjës për dhënien e fjalës.

A.Male: Ju jeni të presionuar sot dhe kjo është e sigurt.

S.Bozdo: Kujdes kur flet Arbër dhe kur më drejtohesh mua,



A.Male: Unë jam një njeri i lirë dhe do flas ashtu sic di unë dhe kur dua unë.

N.Torra: Në lidhje me lidhjen e kontratave dhe minitorimin e tyre në lidhje me minierat është nën drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore por është një problematikë e mbartur që kur u shkrinë komunat pra kanë ardhur si detyrime nga ish-komunat të cilat lidhnin kontrata qeraje dhe kur nuk ishte hequr nga fondi pyjor sipërfaqja që miniera shfrytëzonte. Sot aktualisht nuk mund të lidhësh kontratë nga sipërfaqja që shfrytëzon nuk është hequr nga fondi pyjor. Ato janë detyrime që institucionet përkatëse brenda Bashkisë bëjnë procedurat dhe do ti ndjekin.

E. Karafili: Atëherë të mos ngatrohemi, heqjen nga fondi pyjor nuk e kërkojmë ne, por vetë firma i bën kërkesë fondit pyjor, nuk na takon ne sipas ligjit ta heqim nga fondi pyjor pa bërë kërkesë vetë firma.

M.Kamolli: Po dalim nga tema fare ju lutem.

A.Male; Mua më intereson se jetoj këtu.

K.Topa: Ty të shqetëson ke të drejtë por ti shumicën e kohës keqinterpretton atë që bëhet, kjo stë intereson fare. Neni 72 i Rregullores së Këshillit Bashkiak e thotë qartazi që Këshilltari ka të drejtë të flasë vetëm 2 minuta. E para është bërë radhë kjo punë, Arbëri mirë bën që ngre shqetësimet e tij.

A.Male: Nuk janë shqetësimet e mija por të banorëve.

K.Topa: Në fund të ditës e kuptoj për çfarë e bën. E kam thënë dhe herë tjetër që këto konsultime publike për këtë qëllim bëhen. Arbëri nuk ka qënë ndonjëherë në konsultime, mbase i bën në mënyrën e tij konsultimin. Ti e di shumë mirë që debate me banorët e zonës është bërë për kullotë, jemi dakort këtu. Shtoj këtu që Bashkia këto prona i ka në pronësinë e tij dhe mund të bëjë çfarë të dojë me tokat e tij sepse normalisht do të investojë në prioritet të komunitetit dhe të të ardhurave që do të përfitojë. Mos gaboj shqetësimi i banorëve të zonës ka qënë që ata ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik atje dhe debate ka qënë për kullotë. Prandaj unë mendoj që debate ka mbaruar që në momentin që u hoq kullota. Ajo që po bën ti tani është ajo që bën gjithmonë që përpiqesh të rritësh figurën.

Z.Male: Po ashtu sic e rrit ti figurën tënde.



K.Topa: Unë e rris por jo në këtë formë se është e shëmtuar fare. Diskutimi i banorëve ka mbaruar që në momentin që u hoq kullota sepse ne këtu kemi diskutuar për kullotën që atyre ju duhet për të ushtruar ekonominë e tyre dhe ajo nuk është future fare në Vendimarrje.

A.Male: Ke bërë konsultim? Si të ka rezultuar konsultimi?

K.Topa: Po është bërë konsultimi dhe u dëgjuan mendimet e banorëve u reflektuan, plus nuk përfaqësohet komuniteti me atë përfaqësi që sjell ti. Ju kundra keni qënë dhe kur një banor i zonës shprehu kërkesën për të marrë një sipërfaqe toke për ta punuar. Doja tju thoja që kur jeni kundër duhet të jepni argumenta kundra.

M. Biba: Unë personalisht isha kunder që ky projekt vendim të futej sot në rendin e ditës, gjithsesi doja të thoja dy fjalë.

Është një projekt-vendim që u hodh kundra herën e parë me votat tuaja dhe tonat. Sot rivjen në një mënyrë kaq të shpejtë. Gjithsesi gjithsecili ka përgjegjësi personale që përfaqëson një komunitet dhe kanë ardhur këtu falë votave të atij komuniteti që sot ka nevojë për ju. Faleminderit!

M.Kamolli: Po dikush tjetër e do fjalën? Tja japim fjalën banorëve. Po të lutem prezantohu dhe mere fjalën.

Z.Macolli( Përfaqësues i fshatit Cërravë): Në të njëjtën kohë që folët herën e parë për ato kullota është vazhdimi i atij malit, vargmali i atyre kullotave që tani na kanë ardhur fiks mbi stallë. Jo pa qëllim them që dhe unë po ti mar ato toka pjesën tjetër e lë pa kullotë dhe pa bukë. Është e njëjta parcelë. Pjesën më ta madhe të tokave na i keni lëshuar me qera, merrini dhe këto dhe të ikim fare nga fshati.Me kryetarin kemi folur nja dy herë po ne nuk jemi dakort për këtë.

Syrja Ibi( fshati Lumas) : Luadhin e Celos e kanë marrë dhe nuk po e shfrytëzojnë. Në Cërravë ka pasur kullota të mëdha me bagëti me anën e të cilave mbanin familjet dhe tani kanë mbetur shumë pak. Këta janë për tu kurajuar dhe subvencionuar, jo për tja marrë tokën sic po vepron ju. Po ja u morrë tokën të ikin fare dhe të rrini ju këshilltarët që jeni këtu.

Kevi Mucllari (përfaqësues): Një pyetje kisha sepse këshilltarja përmendi jo është hequr kullota, ju lutem saktësoni për çfarë bëhet fjalë. Bëhet fjalë për 34 hektarë që vazhdojnë të jenë tek I njëjti vend.

N. Torra: Ne e saktësuam, kjo sipërfaqe nuk është kullotë dhe në bazë të ligjit për tokën bujqësore ajo cilësohet pemtore dhe do të trajtohet si pemtore jo kullotë. Nuk mund të lemë pafundësisht pronën e shtetit të mos përdoret, banorët kanë të gjithë të drejtën ligjore ti marrin këto toka ti përdorin gjithashtu dhe me paketën e maleve së fundi të shprehin interesin e tyre për tokën atje ku ata pretendojnë që janë posedues.

Z. Macolli: Çfarë paketë malesh, marroset një atje dhe duhet të marrosemi të gjithë ne?

K. Mucllari: Kush e ka tjetërsuar? Ajo ka qënë pemtore dhe tani është bërë kullotë. Kush e ka bërë?

N. Torra: Ne kullotat I kemi hequr fare.

K. Mucllari: Kjo është njësoj e dëmshme, sepse ju nuk keni qënë atje, keni qënë vetëm te rezervuari. Stallat janë të shpërndara në atë zonë dhe dëmi praktikisht vazhdon të jetë I njëjtë. Nqs bagëtitë e këtyre zotërinjve nuk kanë ku të kullosin dëmi vazhdon të jetë I njëjtë. E dyta nqs ajo është pemtore çfarë projekti ke ti zotëri për ta zhvilluar atë. Në Leshnicë kanë marrë një sipërfaqe të madhe toke për të mbjellë arra, thua çfarë zhvillimi dhe përfitimi ekonomik ka arra. Edyta që është e papranueshme përdor ujin e rezervuarit për të vaditur arrat dhe banorët nuk kanë ujë për të vaditur tokat e tyre. Problem kryesor është që banorët nuk kanë ku të cojnë bagëtitë e tyre. Ky është argumenti që ne kemi dhënë që në fillim dhe vazhdon të mbetet I njëjtë. Nqs ju nuk I jepni një zgjidhje, të gjithë ata që merren me këtë punë janë të prekur ekonomikisht. Që do të thotë, të vetmit që punojnë tokat bujqësore janë ata që merren me blegtori. Pra kjo nga pamja racionale është e papranueshme sepse të vetmit që merren me atë punë ju I thonë mos u merrni dhe tokat bujqësore kanë për të ngelur dierr dhe kjo është e papranueshme. Tjetra dhe kjo po ashtu e rëndësishme në gjykimin tim, u bë një takim me banorët, hajde shkojmë në Cërravë dhe pyesim të gjithë banorët nqs ata janë dakort merrni të gjitha tokat. Ne jemi mirënjohës këshilltarëve që kane votuar kundra. Ju jeni këshilltarë por duhet të keni parasysh që nëpërmjet kësaj vendimmarrje preket një



popull I tërë. Dhe kjo është e fundit dhe e mbyll, atje nuk dihet akoma kush janë investitorët dhe kjo na krijon dyshimin që mund të jenë përfshirë interesa të tjera.

M.Kamolli; Këshilli I jep në parim dhe me sa u sqarua janë hequr kullotat.

I. Xhakolli: Konsultimi publik kur bëhet asjeherë banorët nuk janë dakort por kur tokat janë në pronësi të Bashkisë nuk mund të rimë pa i përdorur dhe pa nxjerrë të ardhura, e kemi për detyrë. Ju që e keni paguar për 30 vjet nuk keni paguar ndnj lekë atje. Pra po ta kishit kërkuar ju më parë sic tha dhe Arbëri këshilltari nuk ka mundësi që të ketë ndodhur sepse është përgjegjësi e jona pastaj. Herën e parë e morëm në konsideratë pjesën e kullotave, 34 ha. E diskutuam dhe e hoqëm, kjo është pemëtore nuk është kullotë, kjo tani më duket si tekë sepse nuk e kuptoj. Madje dhe ai personi që ka pemëtore do ja japim mundësinë që ta marrë. Herën e parë ju dëgjuam dhe ja u plotësuam kërkesën tani nuk është kullotë. Ato i hoqëm sipas kërkesës suaj.

Z.Macolli: Nuk mund të vije një person tjetër që nuk e njohim të na i marrë tokat tona.

I. Xhakolli: Tokat që kemi shtet i nxjerrim në parim për ti dhënë me qera, e kemi detyrim ligjor. Nuk ka as prapaskena asgjë tjetër.

K. Mucllari: Ju ok keni të drejtë po pse nuk nxirrni një lajmërim për të paraqitur kërkesat e tyre banorët. Në gjykimin tim është e pavërtetë që banorët nuk i kanë kërkuar. Nga Bashkia pas mbledhjes së parë kishte ardhur një shkresë ku thuhej që ju duhet të paraqesni kërkesë për të marrë kullotë ose tokë me qera, Pse nuk është bërë kjo më parë?

N. Torra; Në lidhje me njoftimin është një punë rutinë e ndermarjes Pyjore që të gjitha sipërfaqet kullosore mbas miratimit që bën Këshilli Bashkiak për sipërfaqet kullosore, bën njoftim të gjithë kryeqeëve që banorët të njoftohen. Në lidhje me procedurën, me miratimin e Vkb, vendimi shkon në prefekturë dhe fillon procedurat e dhënies me qera. Kur fillon procedura e dhënies me qera specifikohet, publikimi në njoftimin e buletimit të prokurimeve publike në faqen zyrtare të Bashkisë dhe pranë cdo njësie administrative ku ndodhet prona.





I. Xhakolli: Sapo ja u shpjegoi Nexhoja që çfarë janë kullota në të gjithë Bashkinë do I sjellim te ju dhe do vini ti merrni me qera.

M. Kamolli: E hedhim në votim projekt- vendimin

**U votua**

**Pro** 19

**Kundër** 3

**Abstenim** 2

**Miratohet** **Po** **JO**

  
**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

**Pogradec më 10.11.2025**

- Për Akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Taulant Hamolli për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor."

M.Kamolli: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, nuk besoj të kemi diskutime janë ndihma financiare. E hedhim në votim

**U votua**

**Pro** 23

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po JO





-Për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Fatos Hamza, për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor, jashtë vëndit të djalit të tij të mitur, Alteo Hamza".

M.Kamolli: Është e njëjta gjë dhe për këtë projekt vendim. E hedhim në votim.

**U votua**

**Pro** 23

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po JO

M.Kamolli : Mbledhjen e deklaroj të mbyllur

Miratoi! Sekretar e Këshillit